

KUSHTET DHE AFATET

GARANCI PESË-VJEÇARE SAMSUNG

1. Kjo garanci pesë-vjeçare ofrohet nga Samsung [please insert adress of the Samsung entity that offers the warranty as to comply with the legal requirements of the consumer protection law on contractual warranty] dhe është e vlefshme për pajisjet e blera në periudhën nga 02.02.2019 deri më 04.08.2019, vetëm për blerjen e makinave të reja larëse dhe frigoriferëve, disa modele të fshesës me korrent të renditur në faqen e internetit në vijim: www.samsung5vitegaranci.al
**Termi "të rinj" përfshin gjithashtu pajisjet e papërdorura të ekspozimit dhe pajisjeve në shitje.*
2. Ky promovion është i vlefshëm vetëm për makinat tharëse dhe një makinë larëse dhe tharëse e kombinuar të blera në periudhën 2.02.2019 deri 31.03.2019 të cilat cilësohen në faqen Web si në vazhdim: www.samsung5vitegaranci.al.
**Termi "të rinj" përfshin gjithashtu pajisjet e papërdorura të ekspozimit dhe pajisjeve në shitje.*
3. Për të ushtruar të drejtën e garancisë pesë-vjeçare, të gjitha detajet rreth pajisjes duhet të regjistrohen online në faqen e internetit: www.samsung5vitegaranci.al duke ndjekur udhëzimet e dhëna në këtë faqe.
4. Një pajisje për të cilën kërkohet garancia pesë-vjeçare duhet të regjistrohet online (siç tregohet më sipër në pikën 3) jo më vonë se 60 ditë nga data kur është lëshuar fatura e blerjes.
5. Pas regjistrimit, aplikanti do të marrë një email dhe një Letër Garancie për garancinë pesë vjeçare me numrin e serisë së pajisjes së regjistruar.
6. Letra e Garancisë për garancinë pesë-vjeçare duhet të ruhet gjatë gjithë periudhës së garancisë.
7. Garancia pesë-vjeçare nuk mund të transferohet te asnjë pajisje tjetër Samsung, përveç asaj të regjistruar online.
8. Kjo ofertë është e vlefshme vetëm për përdoruesit e fundëm(individë), dhe jo për kompani ose organizata për qëllime rishitjesh ose përdorimi tregtar.
9. Duke e regjistruar pajisjen për garancinë pesë-vjeçare në mënyrën e lartpërmendur, përdoruesit janë dakord me këto Kushte dhe Afate.

„Pajisja duhet të regjistrohet online brenda 60 ditëve nga data e blerjes që dëshmohet në faturë.“

PËLQIM PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PERSONALE SHQIPËRI (Shqip)

Duke klikuar butonin „Regjistrohu“ unë i jap Samsung Electronics Austria GmbH, filialit vendas dhe nënkontraktorëve të tij, pëlqimin tim të shprehur për të mbledhur të dhënat e mia personale përmes kësaj platforme elektronike, dhe për të përdorur të dhënat e mia personale për qëllimin e regjistrimit të pajisjes që kam blerë, për ofrimin e shërbimeve nga qendra e shërbimit Samsung gjatë periudhës 5 vjeçare të garancisë, si dhe për të më kontaktuar në lidhje me sa më sipër. Unë jam njohur me politikën e privatisë së të Samsung e cila është e disponueshme në: <http://www.samsung.com/al/privacy> dhe jap pëlqimin tim të shprehur që të dhënat e mia personale të përpunohen dhe përdoren në përputhje me këtë politikë privatisë.

Unë jam gjithashtu në dijeni për sa më poshtë:

- që Samsung Electronics Austria GmbH, Podružnica Zagreb, Radnička cesta 37, Zagreb, Hrvatska, është kontrolluesi i të dhënave personale,
- që mbledhja e të dhënave personale për qëllimin e këtij promovimi është vullnetare dhe nëse unë zgjedh që të mos i ndaj të dhënat e mia personale me Samsung, unë nuk do të mund të përfitoj nga garancia 5 vjeçare,
- që me kërkesën time, kontrolluesi i të dhënave personale që citohet më lart, do të përditësojë, korrigjojë apo fshijë të dhënat e mia personale nëse ato janë të paplota, të pasakta apo të pa përditësuara, dhe nëse përpunimi i tyre nuk bëhet në përputhje me ligjin e zbatueshëm.